

Termet e Referencës

Ekspert për organizimin e punëtorisë mbi Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Zhvillimit të Kapaciteteve Organizative (OCA dhe OCD)

HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosova/o është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

II. OBJEKTIVA E DETYRËS

Vlerësimi i Kapacitetit Organizativ (OCA) është një proces që kërkon të vlerësojë kapacitetin e çdo organizate në një gamë të gjerë temash. Objektivi i përgjithshëm i konsulencës është:

- Kryerja e një Vlerësimi të Kapacitetit Organizativ duke facilituar një punëtorë pjesëmarrës përmes metodologjisë së përshkruar në mjetin e Save the Children për OCA-në. Punëtorët synon të identifikojë fushat për përmirësim organizativ për të arritur rezultate të qëndrueshme;
- Siguron dokumentacion të plotë gjatë gjithë punëtorisë dhe prodhon një raport që përmbledh rezultatet;
- Ndhmon me zhvillimin e një plani të Zhvillimit të Kapaciteteve Organizative (OCD) për të adresuar fushat e identifikuara në punëtorë.

III. KUALIFIKIMI

Kandidati duhet të posedoj këto aftësi dhe kompetenca:

- Përvojë në zhvillimin e kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC);
- Njohuri të mira të qeverisjes së brendshme të OSHC-ve; menaxhimi i financave të OSHC-ve; zhvillimin e komunikimit, rrjetëzimit, mbledhjes së fondeve dhe politikave tjera relevante për zhvillimin organizativ të OSHC-ve;
- Njohuri dhe përvojë në organizimin, lehtësimin dhe mbajtjen e punëtorëve;
- Diplomë në juridik, shkencë politike, politika publike, ekonomi, sociologji ose fusha të ngjashme.

IV. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË KAPACITETIT ORGANIZATIV

OCA-ja dhe punëtorja mbi të duhet të përdoren si hapi i parë në procesin e Zhvillimit Organizativ dhe duhet të përfshijë përfaqësues të organizatës përmes një punëtorie që synon të shikojë situatën e përgjithshme në kohën e vlerësimit dhe të identifikojë situatën aktuale brenda aspekteve të ndryshme dhe të identifikojë fushat e përmirësimit.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Lehtësuesi (fasilitatori) duhet të kuptojë/analizojë mjetin e Vlerësimit të Kapaciteteve Organizative (OCA) dhe Kornizën e Zhvillimit të Kapaciteteve Organizative (Korniza OCD);
- Lehtësuesi duhet të zhvillojë modulën e punëtorisë bazuar në kërkesat e HANDIKOS dhe Udhëzimeve për OCA/OCD të zhvilluara nga Save the Children;
- Lehtësuesi duhet të mbajë një punëtori 3 ditore me anëtarët e organizatës për të kompletuar Mjetin OCA dhe për të hartuar kornizën OCD;
- Lehtësuesi duhet t'u përmbahet rregullave të përfshirjes dhe transparencës dhe duhet të punojë me politikat e HANDIKOS;
- Lehtësuesi duhet të raportojë për mbarëvajtjen dhe përmbajtjen e punëtorisë;
- Lehtësuesi duhet të rishikojë dhe miratojë modelin e Kornizës së OCD.

VI. REZULTATET KRYESORE

- Lehtësimi dhe dokumentimi i plotë i punëtorisë;
- Hartimi i raportit gjithëpërfshirës i cili përfshin gjetjet e OCA-së dhe rekomandimet për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve organizative të dorëzuara brenda 6 ditëve nga punëtorja;
- Plotësimi i mjetit të OCA-së në gjuhën angleze;
- Raporti përfundimtar duke përfshirë qëllimin e punëtorisë, metodologjinë e përdorur, rezultatet e përgjithshme dhe rekomandimet kryesore për planin e zhvillimit të kapaciteteve organizative;
- Përgatitja njëditore e Kornizës së OCD-së së bashku me HANDIKOS pas punëtorisë.

VII. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Kontrata e detyrës do të jetë për 9 ditë pune brenda afatit kohor prej një muaj.

Afati kohor paraprak për detyrat dhe përgjegjësitë:

Detyra	Kohëzgjatja
Parapërgatitja e punëtorisë dhe materialeve/ analizim me mjetin OCA	2 ditë

Fasilitimi i punëtorisë për hartimin e strategjisë avokuese	3 ditë
Hartimi i raportit	3 ditë
Zhvillimi i kornizës së OCD me HANDIKOS	1 ditë
Totali i ditëve	9 ditë

VIII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas ofertës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të punëtorisë dhe dorëzimit të dokumenteve finale nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë)

HANDIKOS rezervon të drejtën e neqociimit të propozimit financiar.

IX. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë për këtë angazhim (max.1 faqe);
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për “Ekspert për organizimin e punëtorisë mbi Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Zhvillimit të Kapaciteteve Organizative (OCA dhe OCD)”.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 1 nëntor 2023, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve të HANDIKOS dhe Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kritereve të tyre.